



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR / DOREZUAR: DATUM PRILJENJA / DOSTAVLJEN: DATE RECEIVED / SUBMITTED: 11-08-2024			
Njësia Org. Org. Jedn. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Seriales Br. Seriales No. Serial
03	47	1428	10

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	MMPHI	Nr. i Prot. Br. i Prot. Prot. No.	5941/25
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	10	Data: Datum: Date:	11.08.25
PRISHTINË / A			No. 1

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Izedin Bytyqi, u.d. i. Sekretar Përgjithshëm ne MMPHI



PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Ministrinë e
Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për vitin e përfunduar më
31 dhjetor 2024

Nr	Komp. e auditimit (kapitulli)	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja B1 - Mangësi në procesin e regjistrimit të pasurive.	Ministri duhet të shtojë kontrollet në regjistrimin e pasurive si dhe të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet	Do të merren veprimet me të gjitha departamentet përkatëse për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara në mënyra që ti regjistrojmë si pasuri në përdorim.	Zyrtarët e pasurive në bashkëpunim me Departamentet përkatëse.	Në kontinuitet, gjatë tërë vitit fiskal.	

Faqe 1 nga 1

		zhvlerësimi i tyre. Tutje, të siguroj se regjistri i pasurive është i plotë, pasuritë janë regjistruar drejtë dhe reflektojnë vlerën e saktë të tyre në regjistra.	Po ashtu, do të bëjmë edhe pastrimin e regjistrit të pasurive të cilat nuk i plotësojnë kriteret e shpenzimeve kapitale.			
Çështja B4 - Mungesa e evidencave për vijueshmëri në punë	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për angazhimin e këtyre të punësuarve duke siguruar kushte pune, duke përcaktuar objektiva të qarta të punës si dhe të siguroj monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Aktualisht zyrtarët e angazhuar në veri të Kosovës nuk kanë kushte të krijuara të punës. Pas mbajtjes së takimeve me këta zyrtar gjatë këtij viti, ka filluar procesi i punës në shërbimet përkatëse si në Inspektorat, IPH, AMMK, AKK dhe në Departamentin e Administratës dhe ka filluar të raportojnë në baza të rregullta javore për angazhimin e tyre.	Departamentet përkatëse ku janë të angazhuar zyrtarët.			
Çështja B2 - Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontingjente në PFV	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Kemi filluar me përditësimin e regjistrave të detyrimeve kontingjente. Kjo ka ndodh si pasojë e mungesës së stafit të cilin nuk kishim mundësi rekrutimit që nga viti 2019.	Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Shpronësimit.	Qershor 2026.	Përgatitja e Detyrimeve Kontingjente nga ka avancuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Detyrimet Kontingjente janë analizuar dhe korrigjuar	

						thujse tërësisht, ndërsa çdo vit freskohen tabelat me përfundimet e ankesave, duke u bazuar në vendimet gjyqësore të ekzekutueshme.
Çështja B3 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Do të merren veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV.	Departamenti për Buxhet dhe financa në bashkëpunim me Departamentin e Thesarit/MFPT.	Në kontinuitet, gjatë tërë vitit fiskal.		
Çështja B5 - Tejkallim i pagesave për pozicione për kontratat me çmim për njësi	Ministri duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës kontrole të duhura në respektimin e dispozitave ligjore, përkatësisht kushteve të pagesave të parapara sipas llojit të kontratave, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit të tyre kontraktual.	Në bashkëpunim me menaxherët e kontratave dhe Divizionin e Prokurimit, kemi shtuar kapacitetet e kontrollit në mënyrë që asnjë sasi e pozicionit të mos jete e tejkalluar pa një aprovim	Të gjithë Menaxheret e kontratave.	Gjatë tërë vitit fiskal. Në të gjitha kontratat.		

			paraparak.			
	Çështja B6 - Ndryshime në sasi të e paramasës pa aprovim paraparak	Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të kërkohen pëlqimet paraprake dhe aprovimet përkatëse në përputhje me rregullat e aplikueshme.	AK bazuar në rekomandimet të ZKA, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për implementimit e këtij rekomandimi (në kontinuitet), duke u bazuar në LPP, RRPP Neni 70 Dispozitat e Përgjithshme.	Menaxherët e kontratave, Divizioni i Prokurimit dhe ZKA.	Në të gjitha kontratat.	
	Çështja B7 - Vonesa në realizimin e projekteve	Ministri duhet të siguroj se para inicimit të projekteve paraprakisht të kryhet procesi i shpronësimit të tokave në të cilat parashihet realizimi i projekteve si dhe ti kushtohet rëndësi përpilimit/përgatitjes të projekteve ekzekutive në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike	Departamenti i Infrastrukturës Rrugore, do të bëj përpjekje për të mos inicuar asnjë procedurë të prokurimit pa u marrë paraprakisht vendimi për shpronësim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Info: Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm është formuar komisioni për menaxhimin e kontratave për hartimin e projekteve. Komisioni për të gjitha projektet e dhëna për	Departamenti i Infrastrukturës Rrugore në bashkëpunim me shërbimet përkatëse.	Ky rekomandim është duke u zbatuar për projektet e inicuar në vitin 2024.	

			hartim është duke i përcjellur inçizimet gjeodezike, shqyrtimet gjeomekanike dhe aspektet tjera konform kushteve të kontratave Kompanitë projektuese janë të obliguara që për çdo inçizim gjeodezik dhe shqyrtim gjeomekanik paraprakisht ta njoftojnë komisionin dhe të njëjtat të kryejn në prani të komisionit.			
Çështja B9 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore	Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në procesin e shpronësimit, duhet të identifikojnë dobësitë në këtë proces dhe të ndërmarrin masa në evitimin e kontesteve të shumta gjyqësore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë.	MMPHI së bashku me Avokaturën Shtetërore në vazhdimësi është duke zbatuar këtë rekomandim prej se kanë filluar kontestimet gjyqësore.	Departamenti i Tatimit ne Pronë/MFPT.	Në kontinentet.	Kontestet Gjyqësore rrjedhin si rezultat i dispozotave ligjore të përcaktiara me Ligjin për Shpronësim i cili ju jep të drejtë pronarëve të pronave të ushtrojnë ankesë kundër shumës së	

						kompenzimit , shpronësimit të pjeshëm etj.
Çështja B8 - Mangësi në pagesat për shpronësi me	Ministri duhet të siguroj buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve financiare të shpronësimeve si dhe të siguroj që kompensimi të bëhet në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm. Më tutje, ministri të formojë një komision i cili do të analizojë bazën ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet.	Në Projektligjin e ri për fushën e Shpronësimit të Pronës së Paluajtshme është e rregulluar baza ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet. Projektligji është miratuar me vendimin Nr.06/174, dt:22.11.2023 të Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe i njëjti është proceduar në Kuvendin e Kosovës ku ka kaluar leximin e parë.	MMPHI/MFPT	Me miratimin përfundimtar të Ligjit për Shpronësim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.	Kompensimi i pronave të shpronësuara për realizimin projekteve nacionale, realizohet sipas aplikimit të palëve dhe plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm pronësoro - juridik dhe dokumenteve personale për kompensim. Ndërsa sa i përket bazës ligjore për pagesën e interesit të thjeshtë është përfshirë në Projektligjin e ri për fushën e Shpronësimit të	

						Pronës së Paluajtshme
Çështja B10 - Mbajtje e pasurive në klasën jo të duhur në regjistrin e pasurisë	Ministri duhet të siguroj se të gjitha tokat e shpronësuara për të cilat ka përfunduar kompensimi i pronarëve dhe janë plotësuar kushtet e regjistrimit, të regjistrohesh në klasën e pasurive 'Toka', ashtu siç parashihet me planin kontabël. Regjistri i pasurive duhet behet në mënyrë individuale për çdo njësi të tokës së shpronësuar ose mund të grupohen vetëm në raste kur toka lidhet drejt për drejt me realizimin e ndonjë projekti specifik siç është ndërtimi i një rruge të caktuar. Paraprakisht mbajtja e trajnimeve përkatëse për zyrtarë e pasurive do të ndikoj në shtimin e kontrolleve për mbajtjen e regjistrave të sakta dhe të plot të pasurive jo financiare.	Do të merren veprimet e nevojshme që tokat e shpronësuara për të cilat ka përfunduar kompensimi i pronarëve dhe janë plotësuar kushtet e regjistrimit, të regjistrohesh në klasën e pasurive 'Toka', ashtu siç parashihet me planin kontabël.	Zyrtarët e Pasurisë.	e	31/12/2025	
Çështja B11 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare	Ministri duhet të siguroj se komisioni për inventarizimin e pasurive ka përgatitjen dhe njohuritë e duhura lidhur me pasuritë dhe procesin e inventarizimit, si dhe pas këtij procesi të gjitha ndryshimet të reflektohen në regjistrin e pasurive. Po ashtu, të krijohet komisionin i cili do kryej vlerësimin e pasurive sipas	Do të merren veprimet e nevojshme që komisioni për inventarizimin e pasurive ka përgatitjen dhe njohuritë e duhura lidhur me pasuritë dhe procesin e inventarizimit, si dhe pas këtij procesi të gjitha ndryshimet të	Komisioni për regjistrim të pasurisë.	për të	15 Janar 2026.	

		kërkesave të udhëzuesit për menaxhimin e pasurive jo financiare.	regjistrohen në regjistrat përkatës.			
Çështja B12 - Mos ndërmarrja e veprimeve për inkasim të borxheve	Ministri duhet të sigurojë ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijojë mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.	Procesi i ripërtëritjes së kontratave ka filluar nga DMRr-ja dhe do të vazhdojë. Paralelisht, janë ndërmarrë edhe disa riprogramime të borgjeve për disa prej debitorëve, si një mekanizem për përmiresimin e arkëtimit të borgjeve.	Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve.	Afati për ripërtëritjen e kontratave do të jetë 30/06/2026.	Me lansimin e platformes e-dmrr, procesi i arketimit të borgjeve do të bëhet më efikas. Sisitemi I ri do te integrohet me platformë at tjera shteterore dhe do te mundesoje akses në të dhëna të sakta dhe të përditësusara për debitorët, duke rritur kështu transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e detyrimeve financiare.	
Çështja B13 - Komiteti i auditimit jo funksional	Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në	Është adresuar rekomandimi dhe shumë shpejt do të ndërmerren veprimet e nevojshme.	Ministri	31 dhjetor 2025.		

	mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.				
--	---	--	--	--	--